



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2023:207871  
Datë: 13.06.2024  
Numri i dokumentit: 05818938

C.nr.853/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësve A.M, A.K, A.D, A.L, A1.M, B.K, B.M, B1.K, B.D, Dh.L, D.G, D.K, dhe E.K, të gjithë mësimdhënës në SH.F.M.U. “Skender Kastrati” në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati D.M, nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 10,095.28 euro, jashtë seance me datë 13.06.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.M, A.K, A.D, A.L, A1.M, B.K, B.M, B1.K, B.D, Dh.L, D.G, D.K, dhe E.K.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 6.08 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 103.46 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 314.75 euro, në shumën e përgjithshme prej 424.29 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha

këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.D, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.L, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A1.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 6.08 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 103.46 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 314.75 euro, në shumën e përgjithshme prej 424.29 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

VII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,

3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IX. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B1.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 6.08 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 103.46 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 314.75 euro, në shumën e përgjithshme prej 424.29 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

X. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.D, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

XI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Dh.L, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 9.43 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 160.34 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 487.78 euro, në shumën e përgjithshme prej 657.55 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

XII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses D.G, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

XIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit D.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë:

1. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,

2. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
3. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

XIV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit E.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë:

4. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro,
5. për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro,
6. për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, në shumën e përgjithshme prej 704.40 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.09.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

XV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit të parë A.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 424.229 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 294.76 euro. Paditësit të dytë A.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditëses së tretë A.D për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditëses së katërt A.D për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të pestë A1.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 424.29 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 294.76 euro. Paditësit të gjashtë B.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të shtatë B.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të tetë B1.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 424.29 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 294.76 euro. Paditësit të nëntë B.D për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditëses së dhjetë Dh.L, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 657.55 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 61.50 euro. Paditëses së njëmbëdhjetë D.G, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të dymbëdhjetë D.K, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të trembëdhjetë D.K, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro.

XVI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve ti paguaj shumën prej 414.00 €, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

XVII. Refuzohet kërkesa për kompensimin e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar si në pikën XVI të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Paditësit A.M, A.K, A.D, A.L, A1.M, B.K, B.M, B1.K, B.D, Dh.L, D.G, D.K, dhe E.K, në këtë gjykatë me datë 28.09.2023, përmes të autorizuarit të tyre D.M, avokat në Prizren, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 10.11.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. I autorizuari i paditëses përmes parashtresës së datës 11.04.2024 ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që secilit paditës për periudhën kohore për vitin 2020, 2021, dhe 2022, në emër të kompensimit për përqindje të inflacionit në pagë dhe kamatë vonesë vjetore, t’ia kompensoi shumën prej nga: 776.56 euro, e në shumën e përgjithshme prej 10,095.28 €uro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % që nga data e parashtrimit të padisë 19.09.2023 e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 765.00 €.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 13.02.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë më 28.09.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e përqindjes së inflacionit, për periudhën kohore 01.01.2020-21.11.2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësit nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Heronjtë e Kosovës” në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit. Komuna e Rahovecit, si mësimdhënës të ciklit të ulët. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës të datës 31.10.2022 vërtetohet

lartësia e pagës bazë të paditësve A.M, ka pagën 253.60 €, A.K, A.D, A.L, kanë pagën 421.00 €, A1.M, ka pagën 253.60 €, B.K, B.M, kanë pagën 421.00 €, B1.K, ka pagën 253,60 €, B.D, ka pagën 421.00 €, Dh.L, ka pagën 393.00 €, D.G, D.K, dhe E.K kanë pagën 421.00 €. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për paditësit A.K, A.D, A.L, B.K, B.M, B.D, D.G, D.K, dhe E.K dhe atë sipas përlogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ( $421 \times 0.2\% = 0.84 \times 12 = 10.10$ )
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ( $421 \times 3.4\% = 14.31 \times 12 = 171.76$ ).
- Për periudhën Janar- 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.54 € euro ( $421 \times 11.6\% = 48.83 \times 10 = 488.36$  €).  $48.83 \div 30 = 1.62 \times 21$  ditë  $= 34.18 + 488.36 = 522.54$  €.

Paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për paditësit A.M, A1.M, B1.K dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 253.60 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 6.08 euro ( $253.60 \times 0.2\% = 0.50 \times 12 = 6.08$ )
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 253.60 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 103.46 euro ( $253.60 \times 3.4\% = 8.62 \times 12 = 103.46$ ).
- Për periudhën Janar- 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 253.60 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 314.75 euro ( $253.60 \times 11.6\% = 29.41 \times 10 = 294.17$  €).  $29.41 \div 30 = 0.98 \times 21$  ditë  $= 20.58 + 294.17 = 314.75$  €.

Paditës Dh.L i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 393 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 9.43 euro ( $393 \times 0.2\% = 0.78 \times 12 = 9.43$ )
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 393 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 160.34 euro ( $393 \times 3.4\% = 13.36 \times 12 = 160.34$ ).
- Për periudhën Janar- 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 393 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 487.78 euro ( $393 \times 11.6\% = 45.58 \times 10 = 455.88$  €).  $45.58 \div 30 = 1.51 \times 21$  ditë  $= 31.90 + 455.88 = 487.78$  €.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padsisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.

265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata ka vendosur ta refuzojë si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikën XV. të dispozitivit paditësit të parë A.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 424.229 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 294.76 euro. Paditësit të dytë A.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditëses së tretë A.D për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditëses së katërt A.D për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të pestë A1.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 424.29 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 294.76 euro. Paditësit të gjashtë B.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të shtatë B.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të tetë B1.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 424.29 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 294.76 euro. Paditësit të nëntë B.D për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditëses së dhjetë Dh.L, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 657.55 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 61.50 euro. Paditëses së njëmbëdhjetë D.G, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të dymbëdhjetë D.K, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro. Paditësit të trembëdhjetë D.K, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 704.44 euro e deri në shumën prej 719.05 euro dhe atë për shumën prej 14.61 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në *Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve*” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duhet të llogaritet në bazë të pagës bazë 421.00 €, 253.60 €, si dhe 393.00 €. e jo siç kanë kërkuar paditësit në bazë të pagës 421 për gjithë paditësit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë paditësve shumën si në pikën XVI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 414.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 102.00 euro.



Gjykata ka vendosur si në pikën XVII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se shpenzimet tjera për përpilimin e parashtresave të kërkuara nuk hyjnë në shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës gjyqësore konform nenit 452 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.853/2023, më datën 13.06.2024

Bashkëpunëtor profesional

Armond Qmega

Gjyqtari

Betim Behluli

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.